



VENDIM

Nr. 33 Datë 06.04.2011

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“IDRO ENERGJIA PULITA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.04.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “IDRO ENERGJIA PULITA” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “IDRO ENERGJIA PULITA” sh.p.k plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes është në proces përfundimi. (neni 9 pika 4.1.5).

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “IDRO ENERGJIA PULITA” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gostivisht”, “Langarica 3” dhe “Ura e Dashit”.
2. Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
NE DETYRE
Entela Shehaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 33 Datë 06.04.2011

PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“IDRO ENERGJIA PULITA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|--------------------------|-------|--------|
| Bujar Nepravishta | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Shkëlqim Bozgo | _____ | _____ |

